



TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.73

Njësia e Vendosur në Tender Nr.35

Depot ne Zllakuqan

Emri i NSh.-së	NSH KB "Liria"
Lloji i Shitjes	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur
Dita e Ofertimit	25.06.2025 nga ora 10:00h deri 12:00h në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë
Çmimi Minimal	35 €/m ²
Depozita e Ofertës	€ 5,000
Kategoria potenciale për shfrytëzim	Depo
<u>Përshkrimi i Aseteve</u>	
Vendndodhja e Aseteve	Fshati Zllakuqan, Komuna e Klinës. Të dhënat e hartës ©2024 Google Shikoni këtë pronë në Google Maps Aktmohim: Vendndodhjet e treguara nga PIN-at në Google Maps ofrohen vetëm për qëllime të orientimit dhe referencës së përgjithshme. Këto mund të mos pasqyrojnë saktësisht vendndodhjen, kufijtë ose veçori të tjera të asetëve të përshkruara. Përdoruesit këshillohen të verifikojnë në mënyrë të pavarur të gjitha vendndodhjet për çdo çështje që kërkon saktësi ose informacion me rëndësi ligjore. Kjo shitje përfshinë Depo A në sipërfaqe prej 1071m² dhe Depo B në sipërfaqe prej 337m², me sipërfaqe të përgjithshme 1408m². Objektet shtrihen në kuadër të parcelave kadastrale me nr.700-0,701-0 ZK Berkovë, të cilat evidentohen në pronësi të P.Sh Shkolla Fillore Boro Milatoviq Zllakuqan. Toka nuk është pjesë e shitjes. Depot ndodhen afër rrugës Klinë-Istog dhe kanë qasje direkte në rrugë.
Ndërtesat dhe tokat	Nuk ka ndërtesa tjera përveç atyre të përshkruara si më lartë.
Shfrytëzuesit	Ekziston kontrata e qirasë për Depo B, valide deri me 28.02.2026
Asetet tjera	Nuk ka.
Detyrimet që do të barten	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.



Foto/fotot
ose informata të tjera
për asetet në shitje



Informatat rreth Njësish lëndë e shitjes të prezantuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilët dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: www.pak-ks.org.



Raporti i vizitës në terren



RAPORT I VIZITËS NË TERREN KB LIRIA- Depot në Zllakuqan

Me datë 26.03.2025 zyrtarët e AKP ZR Pejë prezent në terren ishim unë Blerta Jashari Kastrati Zyrtare kadastrale dhe Melissa Çeman Morina Zyrtare e operacioneve për administrim të aseteve për identifikimin dhe matjen e depove të cilat sipas listës së aseteve evidentohen në pronësi të "KOPERATIVA BUJQËSORE LIRIA" Z.K Berkovë, Komuna Klinë.

Nga vizita në teren kemi këtë gjendje:

-Objektet/ Depot A dhe B shtrihen në kuadër të parcelave kadastrale me nr të njësisë 700-0, 701-0 ZK Berkovë të cilat sipas evidencës kadastrale evidentohen në pronësi të P.Sh Shkolla Fillore Boro Milatoviq Zllakuqan.

-Objektet/Depot A dhe B janë matur me metër shirit nga themelet e jashtme dhe sipërfaqja e llogaritur është **1408 m²**.

Nr	Objekti/Depo	Dimensionet	Sipërfaqja m ²
1	Depo A	52.5m x 20.4m	1071
2	Depo B	16.5m x 20.4m	337
Sipërfaqja totale :			1408

-Depot kanë qasje në rrugë publike.



Fig.1. Orthofoto



Fig.2. Fotografitë e terrenit

Zyrtare Kadastrale:
Blerta Jashari-Kastrati

Zyrtare e operacioneve për administrim të aseteve:
Melisa Çerman Morina

**Informatat dhe
Dokumentet e Ofertimit**

Divizioni i Marketingut dhe Tenderit Publik
Tel: +383 (0) 38 500 400 lok.1090, 2059
www.pak-ks.org
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rr. Dritan Hoxha, nr.55
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës